

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	Planifikim Biznesor
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	III
Semestri:	V
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda “Planifikimi në Biznes” synon të pajisë studentët me njohuri praktike dhe teorike mbi hartimin e planeve të biznesit, planifikimin e aktiviteteve të brendshme dhe analizimin e mundësive të tregut. Theksohet roli i Inteligjencës Artificiale (IA) në mbështetje të vendimmarrjes strategjike, si analizimi i të dhënave të tregut dhe automatizimi i proceseve operacionale.
Qëllimet e lëndës	Qëllimi i lëndës është të zhvillojë shkathhtësi të hartimit të planit të biznesit, planifikimin dhe analizën e aktiviteteve të ndryshme brenda ndërmarrjes. Të zhvillojnë plane për pikat unike të shitjes duke paraqitur produkte/shërbime si zgjidhje ideale të problemeve të caktuara. Bazuar në këto dhëna studentët krijojnë një bazë lidhur me vendimmarrjen pro ose kundër hyrjes në tregun e caktuar. Të zhvillojë kompetenca praktike në hartimin e planeve të biznesit. Të aftësojë studentët për të analizuar konkurrencën dhe mjedisin e tregut. Të aplikojnë teknologjitë bashkëkohore si AI për të rritur efikasitetin dhe vendimmarrjen në biznes..
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të: 1. Kuptimi i planifikimit në biznes dhe përfitimi i njohurive bazë, (ECTS: 0.5), 2. Identifikimi i mundësive për startup, (ECTS: 0.5), 3. Hartimi i planeve të biznesit, (ECTS: 0.5), 4. Analiza e mjedisit të tregut dhe konkurrencës, (ECTS: 0.5), 5. Planifikimi financiar dhe vlerësimi i qarkullimit, (ECTS: 0.5), 6. Aplikimi i AI në biznes dhe përdorimi i mjeteve si Google Analytics, (ECTS: 0.5), 7. Automatizimi i proceseve përmes AI – raste studimore, (ECTS: 0.5), 8. Prezentimi efektiv i planit të biznesit, (ECTS: 0.5),
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të	

studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë/Vizitë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Përgatitja për detyra projekte			
Projekt kursi – Test (planifikim + zbatim)	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			20
Përgatitja përfundimtare në provim	1	5	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			100
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Kursi zgjat 15 javë me 3 orë leksione dhe/ose ushtrime javore individuale dhe grupore. Metodologjia e Mësimdhënies: Leksione interaktive, ushtrime individuale dhe grupore; Përdorimi i rasteve studimore dhe detyrave praktike; Prezantim i materialeve në formë audio-vizuale dhe përmes teknologjisë (PowerPoint, analiza në Excel, përdorimi i mjeteve AI, etj).		
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në bazë të të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....max 20 pikë (%), ➤ Hartimi / prezantimi i projektit/punim seminarial.....max 20 pikë (%), ➤ Provimi final.....max 60 pikë (%), Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 20 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme: Vijueshmëria në mësim (10 pikë (%)) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. • Aktiviteti (10 pikë (%)) - nënkupton që studenti të kryejë dhe prezantojë detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjërates vijuese. Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulën e lëndës. 2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminarial - vlerësohet me 20 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme, Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo më shumë se 3 studentë) duhet të përgatitë një projekt/punim seminarial (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti		

15 minuta.

Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plot me lëndën.

Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari	
Komponenti	Pikët (%)
Struktura dhe Qëllimi i punimit	6
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	6
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	8
Gjithsej:	20

Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulën e lëndës.

3. Testi i provimit final, vlerësohet me 60 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 30 pikë (%)) për studentët e angazhuar aktiv me pjesëmarrje në ligjërata, testi i parë në javën e 7 ose të 8 dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin nëse ka min 15 pikë (%), pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë studenti mund t'i nënshtrohet testit të dytë studenti ka të drejtë të nënshtrohet drejtpërdrejt provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuara nga senati i Universitetit.

Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:

- ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....**35 pikë (%)**,
- ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jetë në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjëruar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit....**25 pikë (%)**

Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike.

Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit,

Notat në UShAF:

Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm

		8	C	70 - 79	Shumë mirë
		7	D	60 - 69	Mirë
		6	E	50 - 59	Mjaftueshëm
		5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi Tabela inteligjente, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.				
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	60% - Teori, 40% - Ushtrime praktike Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulin e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studentë, kuize studentore në klase, etj). Nga gjithsej 100 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 60% me fokus në teori dhe 40% ushtrime/praktike . • 60 orë janë të dedikuara për ligjëratat teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara në modulin e lëndës. • 40 orë janë të fokusuar në ushtrime/detyra praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi. Ndarja e 4 ECTS sipas raportit 60%-40% ▪ 2.4 ECTS - i dedikohen pjesës teorike, ▪ 1.6 ECTS - i dedikohen pjesës ushtrime/detyra praktike prezantim,.				
Literatura					
Literatura bazë	1. M.Mustafa, E.Kutllovci, P.Gashi, B.Krasniqi, Biznes i vogla dhe të mesme, Prishtinë 2008; 2. McKeever.P.M. 2019. How to write a business plan. Thirteenth edition. Berkeley,				
Literatura shtesë	1. David Meerman Scot – “The new rules of marketing and PR” (in eng) “Rregullat e reja të Marketingut dhe PR-i” (shq), përkthim në shqip Leonard Boduri, Shtëpia Botuese: Living, Tirane 2021, 2. Philip Kotler, Hermawan Kartajaya and Iwan Setiawan – “Marketing 3. 4.0 - Moving from Traditional to Digital”, 2016, Wiley, London, 4. Philip Kotler and Gary Armstrong – “Parimet e Marketingut”, 2013, Tirane,				
Informacion shtesë – Punimi Shkencor nga profesori i lëndës:	*Punimi Shkencor - nga autoret: Aziz Rexhepi, Petrit Hasanaj, Besarta Rexhepi, Arbresh Meha, Titulli – “Models of decision-making in Enterprises” Revista: “Acta universitatis danubius”. Œconomica, vol 16, no 3 (2020), vol. 16, no. 3/2020, pp. 7-16 - Business Administration and Business Economics. HTTPS://WWW.WORLDCAT.ORG/TITLE/8628840923				
Plani i dizajnuar i mësimi:					
Java	Ligjërata që do të zhvillohet				

Java e parë	Hyrje në lëndë dhe prezantimi i syllabusit Njoftimi me lëndën, literaturën, format e vlerësimit, ndarja në grupe. Rezultati i pritur nr. 1.
Java e dytë	Kuptimi i planifikimit në biznes Konceptet bazë dhe rëndësia e planifikimit në menaxhimin e suksesshëm, Rezultati i pritur nr. 2.
Java e tretë	Identifikimi i mundësive për ndërmarrësinë Identifikimi i ideve të reja për start-up dhe analiza e potencialit. Diskutime interaktive, Rezultati i pritur nr. 1 dhe 2.
Java e katërt	Avantazhi konkurrues i biznesit të vogël Si të krijohet dhe mbahet një avantazh konkurrues në treg Diskutime interaktive Rezultati i pritur nr. 3 dhe 4.
Java e pestë	Plani i biznesit – struktura dhe përgatitja Përgatitja e planit të biznesit, komponentët kryesorë, Diskutime interaktive,, Rezultati i pritur nr. 5.
Java e gjashtë	Marketingu në një mjedis konkurrues Strategjitë e marketingut dhe përshtatja në tregje dinamike. Diskutime interaktive. Rezultati i pritur nr. 5.
Java e shtatë	Strategjitë e marketingut Vlerësimi i parë intermediar ku studentët do të vlerësohen me njohurit për gjashte ligjëratat. Rezultati i pritur nr. 5 dhe 6. Parashihet të organizohet Testi i parë,
Java e tetë	Aftësitë e menaxhimit dhe lidhësi, Puna në grupe, zgjedhja e problemeve. Rezultati i pritur nr. 5.
Java e nëntë	Çështje ligjore & analiza SWOT Kuatr ligjor për start-up dhe analiza e mjedisit të brendshëm/jashtëm. Diskutime interaktive. Rezultati i pritur nr. 8.
Java e dhjetë	Çështjet ligjore për Start-up Trendët e tregut. Swot analiza, Plani financiar i biznesit, Projektimi financiar, parashikimet e shitjeve dhe shpenzimeve. Diskutime interaktive. Rezultati i pritur nr. 4.
Java e njëmbëdhjetë	Përdorimi i inteligjencës artificiale në analizën e tregut Hyrje në IA, analiza e të dhënave, identifikimi i trendeve. Diskutime interaktive,

	Rezultati i pritur nr. 6.
Java e dymbëdhjetë	Automatizimi i operacioneve përmes AI Aplikimi i IA në marketing, Chat bot, shërbim ndaj klientit. Rezultati i pritur nr. 7,
Java e trembëdhjetë	Biznesi ndërkombëtar Menaxhimi i bizneseve ndërkombëtare dhe faktorët makroekonomikë. Rezultati i pritur nr. 3.
Java e katërbëdhjetë	Modelet e vendimmarrjes në ndërmarrje (teme nga punimi) Diskutime interaktive. Rezultati i pritur nr. 3,
Java e pesëmbëdhjetë	Planifikimi global, Diskutime interaktive. Vlerësimi i dytë intermedier. Rezultati i pritur nr. 5, Parashihet te organizohet Testi i dytë,
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësuesi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	